



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 18

2003

Mars

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9012
datë 20.2.2003

Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin “Fondi i investimeve sociale, ADF II””... 497

Ligj nr.9013
datë 20.2.2003

Për ratifikimin e “Marrëveshjes shtesë së huasë dhe të projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe KfW-së për projektin “Furnizimi me energji elektrike i Shqipërisë Jugore””..... 499

Ligj nr.9015
datë 20.2.2003

Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për ndihmë në rast aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike”..... 502

Ligj nr.9016
datë 20.2.2003

Për disa ndryshime ne ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8655, datë 31.7.2000 dhe me ligjin nr.8794, datë 10.5.2001..... 511

Vendim i KM nr.94, datë 13.2.2003	Për krijimin e bordit të kullimit për rrethin e Lushnjës.	513
Vendim i KM nr.96, datë 13.2.2003	Për përcaktimin për vitin 2003 të numrit të punonjësve të institucioneve buxhetore.....	514
Vendim i KM nr.116, datë 27.2.2003	Për limitin e përgjithshëm të organikës në Policinë e Shtetit.....	516
Vendim i KM nr.117, datë 27.2.2003	Për njësimin e funksioneve në Policinë e Shtetit me funksionet përkatëse në administratën publike.....	516
Vendim i KM nr.119, datë 27.2.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.119, datë 18.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë.....	518
Vendim i KM nr.120, datë 27.2.2003	Për krijimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.....	520
Vendim i KM nr.123, datë 27.2.2003	Për sigurimin e detyrueshëm, për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, të mjeteve motorike të institucioneve buxhetore.....	521
Vendim i KM nr.125, datë 27.2.2003	Për trajtimin me shtesë, për vështirësi vendi e shërbimi, të ushtarakëve, që shërbejnë në strukturat e brigadës së reagimit të shpejtë dhe të brigadës së stërvitjes.....	521
Vendim i KM nr.126, datë 27.2.2003	Për kriteret e dhënies së lejes së përpunimit industrial dhe/ose të prodhimit të produkteve të duhanit.....	522
Vendim i KM nr.127, datë 13.2.2003	Për një shtesë në vendimin nr.530, datë 31.10.2002 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës-Qafë Thanë”.....	523
Vendim i KM nr.133, datë 7.3.2003	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase, për bashkëpunim në fushën e shëndetësisë dhe të shkencave mjekësore...	524
Vendim i KM nr.134, datë 7.3.2003	Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit.....	527
Vendim i KM nr.136, datë 7.3.2003	Për shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar.....	529

L I G J
Nr.9012, datë 20.2.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR PËR PROJEKTIN “FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE, ADF II””

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin “Fondi i investimeve sociale, ADF II””, me një hua prej 2 045 167, 52 Euro.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3736, datë 19.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR
(VITI 2000)

Në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë:

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;
duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare gjermano-shqiptare nga data 20 deri 23 qershor 200,

ranë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një hua me vlefë prej deri në gjithsej 2.045.167,52 euro (dy milionë e dyzet e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë 52/100 euro) për projektin “Fondi për investime sociale, ADF II”, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur.

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep

mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohej midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe huamarrësit, e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 pragrafi 1 do të zhvleftehet, në rast se kontrata përkatëse për huanë nuk përfundohej brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2008.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është huamarrëse, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratës që do të përfundohej sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezulton nga dhënia e huasë, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 11 dhjetor në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

L I G J

Nr.9013, datë 20.2.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SHITESË SË HUASË DHE TË PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE DHE KFW-SË PËR PROJEKTIN “FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE I SHQIPËRISË JUGORE””

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja “ç” të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja shtesë e huasë dhe e projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe KfW-së për projektin “Furnizimi me energji elektrike i Shqipërisë Jugore””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3737, datë 19.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

SHTESA

E MARRËVESHJES SË KREDISË DHE PROJEKTIT E DATUAR ME MARRËVESHJEN E PROJEKTIT DHE TË HUASË TË DATËS 24 QERSHOR 1999 NDËRMJET KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU, FRANKFURT AM MAIN, (“KfW”) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (“HUAMARRËSI”), I PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (KESH)
 (“AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT) PËR 2.556.459.41 EURO

- Furnizimi me energji elektrike i Jugut të Shqipërisë

Në bazë të marrëveshjes ende të papërfunduar ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për Bashkëpunimin Financiar (“Marrëveshje Qeveritare”), Huamarrësi dhe KfW-ja hyjnë në Marrëveshjen e mëposhtme shtesë të huasë:

Seksioni 1

Modifikimet e Marrëveshjes së huasë

Nenet e mëposhtme të Marrëveshjes së huasë të datës 24 qershor 1999 prej 35,000.000.00 DM duhet të modifikohen si më poshtë:

a) Neni 1.1

“KfW-ja do t’i japë Huamarrësit një hua që nuk kalon shumën 20.451.675.25 euro”

b) Neni 3.2

“KfW-ja do të ketë të drejtën të refuzojë bërjen e disursimeve pas 31 dhjetorit 2008”.

c) Neni 4.4

“Huamarrësi do të ripaguajë huanë si më poshtë”:

Tarifa	Data		Shuma
1	30 dhjetor	2009 euro	292.970,00
2	30 qershor	2010 euro	292.970,00
3	30 dhjetor	2010 euro	292.970,00
4	30 qershor	2011 euro	292.970,00
5	30 dhjetor	2011 euro	292.970,00
6	30 qershor	2012 euro	335.400,00
7	30 dhjetor	2012 euro	335.400,00
8	30 qershor	2013 euro	335.400,00
9	30 dhjetor	2013 euro	335.400,00
10	30 qershor	2014 euro	335.400,00
11	30 dhjetor	2014 euro	335.400,00
12	30 qershor	2015 euro	335.400,00

13	30 dhjetor	2015 euro	335.400,00
14	30 qershor	2016 euro	335.400,00
15	30 dhjetor	2016 euro	335.920,00
16	30 qershor	2017 euro	335.920,00
17	30 dhjetor	2017 euro	335.920,00
18	30 qershor	2018 euro	335.920,00
19	30 dhjetor	2018 euro	335.920,00
20	30 qershor	2019 euro	335.920,00
21	30 dhjetor	2019 euro	335.920,00
22	30 qershor	2020 euro	335.920,00
23	30 dhjetor	2020 euro	335.920,00
24	30 qershor	2021 euro	335.920,00
25	30 dhjetor	2021 euro	335.920,00
26	30 qershor	2022 euro	335.920,00
27	30 dhjetor	2022 euro	335.920,00
28	30 qershor	2023 euro	335.920,00
29	30 dhjetor	2023 euro	335.920,00
30	30 qershor	2024 euro	335.920,00
31	30 dhjetor	2024 euro	335.920,00
32	30 qershor	2025 euro	335.920,00
33	30 dhjetor	2025 euro	335.920,00
34	30 qershor	2026 euro	335.920,00
35	30 dhjetor	2026 euro	335.920,00
36	30 qershor	2027 euro	335.920,00
37	30 dhjetor	2027 euro	335.920,00
38	30 qershor	2028 euro	335.920,00
39	30 dhjetor	2028 euro	335.920,00
40	30 qershor	2029 euro	335.920,00
41	30 dhjetor	2029 euro	335.920,00
42	30 qershor	2030 euro	335.920,00
43	30 dhjetor	2030 euro	335.920,00
44	30 qershor	2031 euro	335.920,00
45	30 dhjetor	2031 euro	335.920,00
46	30 qershor	2032 euro	336.430,00
47	30 dhjetor	2032 euro	336.430,00
48	30 qershor	2033 euro	336.430,00
49	30 dhjetor	2033 euro	336.430,00
50	30 qershor	2034 euro	336.430,00
51	30 dhjetor	2034 euro	336.430,00
52	30 qershor	2035 euro	336.430,00
53	30 dhjetor	2035 euro	336.430,00
54	30 qershor	2036 euro	336.430,00
55	30 dhjetor	2036 euro	336.430,00
56	30 qershor	2037 euro	336.430,00
57	30 dhjetor	2037 euro	336.430,00
58	30 qershor	2038 euro	336.430,00
59	30 dhjetor	2038 euro	336.430,00
60	30 qershor	2039 euro	336.430,00
61	30 dhjetor	2039 euro	336.430,00
62	30 qershor	2040 euro	42.945,25
63	30 dhjetor	2040 euro	42.960,00
64	30 qershor	2041 euro	42.960,00
65	30 dhjetor	2041 euro	42.945,25

Shuma		20.451.675,25
-------	--	---------------

1.2 Të gjitha nenet e tjera të Marrëveshjes së huasë dhe projektit të datës 24 qershor 1999 do të mbeten të pandryshuara.

Seksioni 2

Nene suplementare

2.1 Detyrimi i angazhimit për shumën e huasë shtesë prej 2,556,459.41 euro do të llogaritet për një periudhë që fillon tre muaj pas firmosjes së Marrëveshjes shtesë të huasë dhe projektit dhe mbaron në datat në të cilat debitohej disbursimet.

2.2 Në mënyrën e duhur para disbursimit të parë nga shuma e huasë shtesë, Huamarrësi duhet t'i sigurojë KfW-së, në mënyrë të kënaqshme për KfW-në, një evidencë që provon se Huamarrësi i ka plotësuar të gjitha kërkesat ligjore dhe nënligjore për një kuptim të vlefshëm të të gjitha detyrimeve që Huamarrësit i lindin nga kjo Marrëveshje.

9.5 Kjo shtesë huaje dhe Marrëveshje projekti nuk do të hyjë në fuqi përderisa Marrëveshja qeveritare mbi të cilën ajo është bazuar, ka hyrë në fuqi.

Hartuar në gjashtë origjinale, tri prej të cilave në Gjermanisht dhe tri në anglisht.

Frankfurt am Main

Tiranë, më 5.10.2002

Kreditansalt für Wiedenaufbau

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave
Kastriot Islami
Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
(KESH)

L I G J

Nr.9015, datë 20.2.2003

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN PËR NDIHMË NË RAST AKSIDENTI BËRTHAMOR OSE EMERGJENCE RADIOLOGJIKE”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për ndihmë në rast aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3739, datë 19.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

KONVENTË
PËR NDIHMË NË RAST AKSIDENTI BËRTHAMOR OSE EMERGJENCE RADIOLOGJIKE

Shtetet pjesëmarrës të kësaj konvente:
të ndërgjegjshëm se veprimtaritë bërthamore po zhvillohen në një numër shtetesh;
duke vërejtur se janë marrë dhe po merren masa të gjithanshme për të arritur një nivel të lartë sigurie në veprimtaritë bërthamore, me qëllim që të parandalohen aksidentet bërthamore dhe të pakësohen pasojat e ndonjë aksidenti të tillë, edhe sikur ai të ndodhte;
duke dëshiruar të forcojnë më shumë bashkëpunimin ndërkombëtar për një zhvillim dhe përdorim të sigurt të energjisë bërthamore;
të bindur për nevojën e një sistemi ndërkombëtar, i cili do të lehtësojë dhënien e menjëhershme të ndihmës në rast aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike për të pakësuar pasojat e tyre,
duke vërejtur dobinë e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe për ndihmë reciproke në këtë fushë;
duke vënë theksin në veprimtaritë e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike për të krijuar udhëzues për marrëveshjet e ndihmës emergjente reciproke në lidhje me një aksident bërthamor ose emergjence radiologjike,
ranë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme

1. Shtetet pjesëmarrëse do të bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (që këtej e tutje do të quhet “Agjenci”) në përputhje me kushtet e kësaj Konvente për të lehtësuar ndihmën e menjëhershme në rast aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike për të pakësuar pasojat e tyre dhe për të mbrojtur jetën, pasurinë dhe mjedisin nga efektet e daljeve radioaktive.
2. Për të lehtësuar një bashkëpunim të tillë, shtetet pjesëmarrëse mund të bëjnë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, ose kur është e përshtatshme në marrëveshje të kombinuara për të parandaluar ose minimizuar dëmet dhe dëmtimet.
3. Shtetet pjesëmarrëse i kërkojnë Agjencisë, që duke vepruar në kuadrin e statutit të saj, të bëjë përpjekje maksimale në përputhje me kushtet e kësaj Konvente që të nxisë, të lehtësojë dhe mbështesë bashkëpunimin midis shteteve pjesëmarrëse duke u bazuar në këtë Konventë.

Neni 2

Kushtet e ndihmës

1. Në qoftë se një shtet pjesëmarrës kërkon ndihmë në rast aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike, pavarësisht nëse një aksident ose emergjencë e ka ose jo origjinën brenda territorit, juridiksionit ose kontrollit të tij, ai mund të kërkojë një ndihmë të tillë prej ndonjë shteti tjetër pjesëmarrës, direkt ose nëpërmjet Agjencisë si dhe prej Agjencisë ose kur është e përshtatshme prej organizatave të tjera ndërkombëtare ndërqeveritare (që këtej e tutje do të quhen “organizata ndërkombëtare”).
2. Një shtet pjesëmarrës që kërkon ndihmë do të specifikojë qëllimin dhe llojin e ndihmës, dhe kur është e mundur do t’i sigurojë palës ndihmëse një informacion të tillë të nevojshëm për palën tjetër që të përcaktojë se deri në çfarë shkalle ajo është e aftë t’i përgjigjet kërkesës. Kur shteti pjesëmarrës që kërkon ndihmë nuk është në gjendje të specifikojë qëllimin dhe llojin e ndihmës së kërkuar, shteti pjesëmarrës kërkuar dhe pala ndihmuese, nëpërmjet këshillimeve, do të vendosin për qëllimin dhe llojin e ndihmës së kërkuar.
3. Çdo shtet pjesëmarrës, të cilit i dërgohet kërkesa për ndihmë, do të vendosë menjëherë dhe do të njoftojë shtetin pjesëmarrës kërkuar, direkt ose nëpërmjet Agjencisë, nëse është në gjendje të japë ndihmën e kërkuar, si dhe qëllimin dhe kushtet e ndihmës që mund të japë.
4. Shtetet pjesëmarrëse, brenda kufijve të aftësive të tyre, do të përcaktojnë dhe njoftojnë Agjencinë për ekspertët, pajisjet dhe materialet që do të mund të ishin të disponueshme për dhënien e

ndihmës shteteve të tjera pjesëmarrëse në rast aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike, si dhe kushtet, veçanërisht ato financiare, me të cilat kjo ndihmë mund të jepet.

5. Çdo shtet pjesëmarrës mund të kërkojë ndihmë për trajtimin mjekësor ose për qëndrim të përkohshëm në territorin e një shteti tjetër pjesëmarrës, të njerëzve që janë përfshirë në një aksident bërthamor ose emergjencë radiologjike.

6. Agjencia, në përputhje me statusin e saj, si dhe në frymën e kësaj Konvente, do t'i përgjigjet kërkesës së një shteti pjesëmarrës kërkuar ose të një shteti anëtar në rast aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike:

- a) duke vënë në dispozicion burime të përshtatshme të caktuara për këtë qëllim;
- b) duke ua transmetuar kërkesën menjëherë shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare, të cilat sipas informacioneve që ka Agjencia, mund të disponojnë burimet e nevojshme;
- c) duke bashkërenduar ndihmën në nivel ndërkombëtar, që kështu bëhet e përdorshme, nëse këtë e kërkon shteti kërkuar.

Neni 3

Drejtimi dhe kontrolli i ndihmës

Nëse nuk është rënë dakord ndryshe:

a) Drejtimi, kontrolli, koordinimi dhe mbikëqyrja e gjithanshme e ndihmës, brenda territorit të vet, do të bëhet nën përgjegjësinë e shtetit kërkuar. Kur ndihma përfshin edhe personel, pala që ndihmon në këshillim me shtetin kërkuar, duhet të caktojë personin që do të jetë përgjegjës dhe do të kryejë mbikëqyrjen e menjëhershme operacionale për personelin dhe pajisjet e siguruar. Personi i caktuar do ta ushtrojë mbikëqyrjen në bashkëpunim me autoritetet përkatëse të shtetit kërkuar.

b) Shteti kërkuar do të sigurojë brenda mundësive të tij shërbime dhe lehtësira lokale për administrimin me efektivitet të ndihmës. Ai do të sigurojë gjithashtu mbrojtjen e personelit, pajisjeve dhe materialeve të sjella në territorin e tij, vetë ose në emër të palës ndihmëse për këtë qëllim.

c) Pronësia e pajisjeve dhe e materialeve që jepen nga secila palë gjatë periudhës së ndihmës, do të mbeten të paprekura dhe do të sigurohet kthimi i tyre.

d) Një shtet pjesëmarrës që jep ndihmë në përgjigje të një kërkesë, sipas paragrafit 5 të nenit 2, do të koordinojë këtë ndihmë brenda territorit të tij.

Neni 4

Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit

1. Çdo shtet pjesëmarrës do t'i bëjë të njohur Agjencisë së shteteve pjesëmarrëse, direkt ose nëpërmjet Agjencisë, autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit të autorizura për të bërë dhe për të marrë kërkesat, si dhe për të pranuar ofertat e ndihmës. Këto pika kontakti, si dhe një pikë qendrore brenda Agjencisë, do të jenë të disponueshme në mënyrë të vazhdueshme.

2. Çdo shtet pjesëmarrës do të informojë menjëherë Agjencinë për çdo ndryshim që mund të ndodhë në informacionin sipas paragrafit 1.

3. Agjencia do t'u japë shteteve pjesëmarrëse, shteteve anëtare dhe organizatave përkatëse ndërkombëtare në mënyrë të rregullt dhe të menjëhershme informacionin sipas paragrafit 1.

Neni 5

Funksionet e Agjencisë

Shtetet pjesëmarrëse i kërkojnë Agjencisë, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 1 dhe pa paragjykim për dispozitat e tjera të kësaj Konvente që:

a) Të mbledhë dhe t'u shpërndajë shteteve pjesëmarrëse dhe shteteve anëtare informacion në lidhje me:

i) ekspertët, pajisjet dhe materialet që do të vihen në dispozicion në rast aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike;

ii) metodologjitë, teknikat dhe rezultatet e kërkimeve të disponueshme, në lidhje me masat që duhet të merren ndaj një aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike.

b) Të ndihmojë një shtet pjesëmarrës ose një shtet anëtar, kur ndihma kërkohet për secilën nga

çështjet e mëposhtme ose të ngjashme:

i) në përgatitjen e planeve të emergjencave në rast aksidenti bërthamor dhe emergjence radiologjike, si dhe të legjislacionit të përshtatshëm;

ii) në zhvillimin e programeve të përshtatshme kualifikuese për personelin që do të trajtojë aksidentet bërthamore dhe emergjencat radiologjike;

iii) në transmetimin e kërkesave për ndihma dhe informacione përkatëse në rastin e një aksidenti bërthamor ose të emergjencës radiologjike;

iv) në zhvillimin e programeve, procedurave dhe standardeve të përshtatshme për monitorimin e rrezatimeve;

v) në kryerjen e studimeve për mundësinë e vendosjes së sistemeve të përshtatshme për monitorimin e rrezatimeve;

c) Do t'i verë në dispozicion një shteti pjesëmarrës ose një shteti anëtar, që kërkon ndihmë në rast të një aksidenti bërthamor ose të një emergjence radiologjike, burimet e përshtatshme, të caktuara për të bërë një vlerësim fillestar të shkallës së aksidentit dhe të emergjencës radiologjike.

d) Do t'u ofrojë shërbimet e saj shteteve pjesëmarrëse dhe shteteve anëtare në rast të një aksidenti bërthamor ose të një emergjence radiologjike.

e) Do të vendosë dhe do të mbajë lidhje me organizatat përkatëse ndërkombëtare me qëllim që të marrë dhe të shkëmbejë informacione dhe të dhëna përkatëse, si dhe do të bëjë një listë të organizatave, që do të jetë në dispozicion të shteteve pjesëmarrëse, shteteve anëtare dhe organizatave të lartpërmendura.

Neni 6

Sekreti dhe deklaratat publike

1. Shteti kërkuar dhe shteti që ndihmon do të ruajnë sekretin e çfarëdolloj informacioni sekret që i jepet secilës palë në lidhje me ndihmën në rast aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike. Një informacion i tillë do të përdoret ekskluzivisht për ndihmën që është dhënë në lidhje me një aksident bërthamor ose emergjence radiologjike.

2. Pala që ndihmon do të bëjë të gjitha përpjekjet për të koordinuar me shtetin kërkuar, para dhënies së informacionit në publik, për ndihmën që është dhënë në lidhje me aksidentin bërthamor ose emergjencën radiologjike.

Neni 7

Pagimi i shpenzimeve

1. Një palë ndihmëse mund të ofrojë ndihma pa pagesë për shtetin kërkuar. Kur shqyrtohet mundësia e dhënies së një ndihme në këto kushte, pala ndihmuese duhet të ketë parasysh:

a) natyrën e aksidentit bërthamor ose të emergjencës radiologjike;

b) vendndodhjen e aksidentit bërthamor ose të emergjencës radiologjike;

c) nevojat e vendeve në zhvillim;

d) nevojat e veçanta të vendeve që nuk kanë impiante bërthamore;

e) çfarëdolloj faktori tjetër.

2. Kur ndihma jepet plotësisht ose pjesërisht mbi bazën e pagesës, shteti kërkuar do t'i paguajë palës që ndihmon shpenzimet e bëra për shërbimet e kryera nga persona ose organizata që veprojnë në emër të saj, si dhe të gjitha shpenzimet e tjera që lidhen me ndihmën dhe që nuk janë paguar direkt nga shteti kërkuar. Në rast se nuk është rënë dakord ndryshe, pagesa do të jepet menjëherë mbasi pala që ndihmon i ka paraqitur kërkesën e saj për pagim shtetit kërkuar dhe përsa i përket shpenzimeve të tjera, përveç shpenzimeve lokale, ato do të jenë të transferueshme lirisht.

3. Pavarësisht nga paragrafi 2, pala që ndihmon mundet që në çdo kohë të mos ngulë këmbë ose të bjerë dakord për shtyrjen e pagesës plotësisht ose pjesërisht. Duke mos ngulur këmbë ose duke bërë shtyrje, palët që japin ndihmë do të marrin parasysh nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 8

Privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat

1. Shteti kërkues do t'i akordojë personelit të shtetit që ndihmon dhe personelit që vepron në emër të tij, privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre të ndihmës.

2. Shteti kërkues do t'i akordojë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme personelit të palës që ndihmon ose personelit që vepron në emër të tij dhe për të cilin është njoftuar sipas rregullave dhe është pranuar nga shteti kërkues:

a) imunitet nga ndalimi, burgosja dhe procesi ligjor duke përfshirë juridiksionin kriminal, civil, administrativ dhe atë për krime të shtetit kërkues, përsa i përket kryerjes ose moskryerjes së detyrave të tyre;

b) përjashtim nga taksat, detyrimet dhe tarifat e tjera, përveç atyre që inkuadrohen normalisht në çmimin e mallrave ose që paguhet për shërbimet e kryera lidhur me kryerjen e funksioneve të tyre të ndihmës.

3. Shteti kërkues:

a) do t'i akordojë shtetit që ndihmon përjashtim nga taksat, detyrimet dhe tarifat e tjera për pajisje dhe pasuri, që sillen në territorin e shtetit kërkues nga shteti që ndihmon, për qëllimin e ndihmës;

b) do t'i akordojë imunitet nga marrja, përvetësimi ose rekuizimi i këtyre pajisjeve dhe pasurive.

4. Shteti kërkues do të sigurojë kthimin e këtyre pajisjeve dhe pasurive. Në qoftë se kërkohet nga shteti që ndihmon, shteti kërkues do të krijojë kushte, brenda mundësive të tij, për dekontaminimin e nevojshëm të pajisjeve të kthyeshme të përdorura gjatë ndihmës, përpara se ato të kthehen.

5. Shteti kërkues do të lehtësojë hyrjen, qëndrimin dhe largimin nga territori i tij kombëtar, të personelit që përmban paragrafi 2 dhe të pajisjeve dhe pasurive që përfshihen në ndihmë.

6. Në këtë nen nuk kërkohet aspak që shteti kërkues t'u akordojë nënshtetasve të tij ose atyre që janë me qëndrim të përhershëm, privilegjet dhe imunitetet e akorduara në paragrafët e mësipërm.

7. Pa paragjykuar privilegjet dhe imunitetet, të gjithë ata që gëzojnë privilegje dhe imunitete të tilla sipas këtij neni, kanë për detyrë që të respektojnë ligjet dhe rregullat e shtetit kërkues. Ata kanë gjithashtu për detyrë që të mosndërhyjnë në punët e brendshme të shtetit kërkues.

8. Asgjë në këtë nen nuk dëmton të drejtat dhe detyrimet përsa u përket privilegjeve dhe imuniteteve që akordohen në lidhje me marrëveshje të tjera ndërkombëtare ose rregulla të së drejtës ndërkombëtare.

9. Duke firmosur, ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në këtë Konventë, një shtet mund të deklarojë se ai nuk e konsideron veten të angazhuar plotësisht ose pjesërisht me paragrafët 2 dhe 3.

10. Një shtet pjesëmarrës që ka bërë një deklaratë, në përputhje me paragrafin 9, mund ta tërheqë atë në çdo kohë duke njoftuar depozituesin.

Neni 9

Kalimi i personave, pajisjeve dhe pasurive

Çdo shtet pjesëmarrës me kërkesën e shtetit kërkues ose të shtetit që ndihmon, do të kërkojë lehtësira për kalimin nëpër territorin e tij, të personelit, pajisjeve dhe pasurive që hyjnë ose dalin nga shteti kërkues dhe që janë të përfshira në ndihmë.

Neni 10

Ankesat dhe kompensimi

1. Shtetet pjesëmarrëse do të bashkëpunojnë ngushtë, me qëllim që të lehtësojnë zgjidhjen e procedurave ligjore dhe ankesave sipas këtij neni.

2. Në qoftë se nuk është rënë dakord ndryshe, lidhur me vdekjen ose dëmtimin e personave, dëmtimin ose humbjen e pasurive, ose dëmtimin e mjedisit brenda territorit të vet ose të një zone tjetër nën juridiksionin ose kontrollin e vet, gjatë dhënies së ndihmës së kërkuar, shteti kërkues:

a) nuk do të kryejë ndonjë procedurë ligjore kundër palës që ndihmon ose personave, ose subjekteve të tjera ligjore, që veprojnë në emër të saj;

b) do të mbajë përgjegjësi për të trajtuar procedurat ligjore dhe ankesat e një pale të tretë

kundër palës që ndihmon ose kundër personave ose subjekteve të tjera ligjore që veprojnë në emër të saj;

c) do të mbajë padëmtuar palën që ndihmon ose personat ose subjektet e tjera ligjore që veprojnë në emër të saj përse u përket procedurave ligjore që parashikohen në nënparagrafin (b);

d) do të kompensojë palën ose subjektet e tjera ligjore që veprojnë në emër të saj:

i) për vdekjen ose dëmtimin e personelit të palës që ndihmon ose të personave që veprojnë në emër të saj;

(ii) për humbjen ose dëmtimin e pajisjeve ose të materialeve të pakonsumueshme që kanë të bëjnë me ndihmën, përveç rasteve të sjelljeve të ulta nga persona që kanë shkaktuar vdekje, dëmtim, humbje ose plagosje.

3. Ky nen nuk do të pengojë kompensimin ose dëmshpërblimin që parashikohet në çfarëdo marrëveshje ndërkombëtare të zbatueshme ose ligj kombëtar të çdo shteti.

4. Asgjë në këtë nen nuk do të kërkojë që shteti kërkuar të zbatojë paragrafin 2 plotësisht ose pjesërisht për nënshtetasit ose banorët e vet të përkohshëm.

5. Kur firmos, ratifikon, pranon ose aderon në këtë Konventë, një shtet mund të deklarojë:

a) se ai nuk e konsideron veten të lidhur plotësisht ose pjesërisht me paragrafin 2;

b) se ai nuk do të zbatojë paragrafin 2 plotësisht ose pjesërisht, në rastet e një neglizhence të madhe nga individë që shkaktojnë vdekje, plagosje, humbje ose dëmtim.

6. Një shtet pjesëmarrës që ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin 5 mund ta tërheqë atë në çdo kohë duke njoftuar depozituesin.

Neni 11

Përdorimi i ndihmës

Shteti kërkuar ose pala që ndihmon, në çdo kohë pas këshillimeve të përshtatshme dhe duke njoftuar me shkrim, mund të kërkojë dhënie fund të ndihmës së marrë ose të dhënë sipas kësaj Konvente.

Menjëherë sapo bëhet një kërkesë e tillë, palët e përfshira do të këshillohen me njëra-tjetrën për të bërë rregullimet për një përfundim korrekt të dhënies së ndihmës.

Neni 12

Lidhja me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Kjo Konventë nuk do të ndikojë tek të drejtat dhe detyrimet reciproke të shteteve pjesëmarrëse që rrjedhin nga marrëveshjet ekzistuese ndërkombëtare, të cilat lidhen me çështje që mbulon kjo Konventë ose që rrjedhin nga marrëveshje ndërkombëtare të së ardhmes të parashikuara në përputhje me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rast mosmarrëveshjeje midis shteteve pjesëmarrëse dhe Agjencisë, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, palët që nuk merren vesh do të këshillohen me qëllim që të zgjidhin mosmarrëveshjen me anë bisedimesh ose me ndonjë mjet paqësor të pranueshëm prej tyre.

2. Nëse një mosmarrëveshje e këtij karakteri midis shteteve pjesëmarrëse nuk do mund të zgjidhet brenda një viti pas kërkesës për këshillim, sipas paragrafit 1, me kërkesën e secilës palë në mosmarrëveshje, çështja i kalohet arbitrazhit ose Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, për vendim. Nëse brenda gjashtë muajve, nga data e kërkesës për ta çuar mosmarrëveshjen në arbitrazh, palët janë të paafta të bien dakord për organizimin e arbitrazhit, secila prej palëve mund t'i kërkojë Kryetarit të Gjykatës Ndërkombëtare ose Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të caktojë një ose më shumë arbitra. Në rast kërkesash kontradiktore nga palët në mosmarrëveshje, kërkesa drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara do të ketë përparësi.

3. Gjatë nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, një shtet mund të deklarojë se nuk e konsideron veten të lidhur nga secila ose të dyja procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të treguara në paragrafin 2 ndaj një shteti pjesëmarrës për të cilin qëndron në fuqi

një deklaratë e tillë.

4. Një shtet pjesëmarrës, që ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin 3, mund ta tërheqë atë në çdo kohë duke njoftuar depozituesin.

Neni 14

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për firmosje për të gjitha shtetet dhe Namibinë, të përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë, në rezidencën e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike në Vjenë dhe në rezidencën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork prej 26 shtatorit 1986 dhe 6 tetorit 1986 përkatësisht, deri në hyrjen në fuqi të saj ose për dymbëdhjetë muaj, duke zgjedhur periudhën më të gjatë.

2. Një shtet dhe Namibia, e përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë, mund të shprehin miratimin për t'u bashkuar me këtë Konventë ose duke e firmosur, ose duke depozituar një instrument ratifikimi, pranimi ose miratimi, ose duke depozituar një instrument aderimi. Instrumentet e ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit do të depozitohen tek depozituesi.

3. Kjo Konventë hyn në fuqi tridhjetë ditë, pasi të jetë shprehur pranimi i saj nga tre shtete.

4. Për çdo shtet që shpreh pëlqimin për t'u lidhur me këtë Konventë pas hyrjes së saj në fuqi, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për shtetin, tridhjetë ditë pas datës së shprehjes së pëlqimit.

5. a) Kjo Konventë do të jetë e hapur për aderim, sikurse sigurohet nga ky nen, nga organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e integritetit rajonal që formohen nga shtetet sovraane, të cilat kanë kompetencë për të bërë negociata, zbatime dhe përfundime të marrëveshjeve ndërkombëtare për fusha që i mbulon kjo Konventë.

b) Brenda kompetencave të tyre, këto organizata, në emër të tyre, do të ushtrojnë të drejtat dhe plotësojnë detyrimet që kjo Konventë u atribuon shteteve pjesëmarrëse.

c) Kur depoziton instrumentin e vet të aderimit, një organizatë ndërkombëtare do t'i komunikojë depozituesit një deklaratë ku i tregon shtrirjen e kompetencave të saj në lidhje me fushat që mbulon kjo Konventë.

d) Një organizatë e tillë nuk ka të drejtë vote; nuk u shtohet asnjë votë, votave të shteteve pjesëmarrëse.

Neni 15

Zbatimi i përkohshëm

Një shtet, që nga firmosja ose më vonë, por pa hyrë në fuqi Konventa për të, mund të deklarojë se do ta zbatojë këtë Konventë përkohësisht.

Neni 16

Amendamentet

1. Një shtet pjesëmarrës mund të propozojë amendamente për këtë Konventë. Amendamenti i propozuar do t'i dërgohet depozituesit, i cili do ta qarkullojë atë menjëherë në të gjitha shtetet pjesëmarrëse.

2. Nëse shumica e shteteve pjesëmarrëse i kërkon depozituesit të thërrasë një konferencë për të shqyrtuar amendamentin e propozuar, depozituesi do të ftojë të gjitha shtetet pjesëmarrëse të vijnë në këtë konferencë, që fillon jo më parë se tridhjetë ditë pas dërgimit të ftesave. Çdo amendament që pranohet nga konferenca me dy të tretat e votave të të gjitha shteteve pjesëmarrëse, do të futet në një protokoll, që është i hapur për firmë në Vjenë dhe Nju Jork për të gjitha shtetet pjesëmarrëse.

3. Protokollin hyn në fuqi tridhjetë ditë pas pëlqimit të shprehur nga tre shtete. Për çdo shtet, që shpreh pëlqimin për të qenë i lidhur me këtë protokoll pas hyrjes së tij në fuqi, protokollin do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas datës së shprehjes së pëlqimit.

Neni 17

Denoncimi

1. Një shtet pjesëmarrës mund ta denoncojë këtë Konventë duke njoftuar me shkrim depozituesin.

2. Denoncimi do të marrë efekt një vit pas datës së marrjes të njoftimit nga depozituesi.

Neni 18 **Depozituesi**

1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë do të jetë depozituesi i kësaj Konvente.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë do të njoftojë menjëherë të gjitha shtetet pjesëmarrëse dhe shtetet e tjera për:

çdo firmosje të kësaj Konvente ose ndonjë protokoll amendamenti;

b) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, lidhur me këtë Konventë ose me ndonjë protokoll amendamenti;

c) çdo deklaratë ose tërheqje prej saj në përputhje me nenet 8, 10 dhe 13;

d) çdo deklaratë për zbatim të përkohshëm të kësaj Konvente sipas nenit 15;

e) hyrjen në fuqi të kësaj Konvente ose të ndonjë amendamenti;

f) ndonjë denoncim të bërë sipas nenit 17.

Neni 19 **Tekstet origjinale dhe kopjet e vërtetuara**

Origjinali i kësaj Konvente, tekstet e të cilës në gjuhët arabe, kineze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njëloj autentike, do të depozitohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, i cili do t'u dërgojë kopje të vërtetuara shteteve pjesëmarrëse dhe të gjitha shteteve të tjera.

Si dëshmi e kësaj, nënshkruesi, duke qenë i autorizuar sipas të gjitha rregullave, ka firmosur këtë Konventë, të hapur për firmosje sipas paragrafit 1 të nenit 14.

Miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike në Vjenë në datën 26 shtator 1986.

L I G J **Nr.9016, datë 20.2.2003**

PËR DISA NDRYSHIME NE LIGJIN NR.8410, DATË 30.09.1998 “PËR RADION DHE TELEVIZIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8655, DATË 31.07.2000 DHE ME LIGJIN NR.8794, DATË 10.5.2001

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8655, datë 31.7.2000 dhe me ligjin nr.8794, datë 10.5.2001, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7 paragrafi i dytë i pikës 19 ndryshohet si më poshtë:

“Kuvendi miraton raportin vjetor për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij. Nëse

për dy vjet radhazi, Kuvendi nuk miraton raportin vjetor për veprimtarinë e KKRT-së, atëherë KKRT-ja shpërndahet. KKRT-ja rizgjidhet sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj, por jo më vonë se tridhjetë ditë pas shpërndarjes së Këshillit paraardhës.”.

Neni 2

Neni 88 ndryshohet si më poshtë:

“Këshilli Drejtues i RTSH-së përbëhet nga 15 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Kandidaturat propozohen nga Komisioni i Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik. Komisioni i paraqet Kuvendit listën me dyfishin e kandidatëve si më poshtë:

a) 10 anëtarë zgjidhen në numër të barabartë ndërmjet 20 kandidaturave të propozuara nga pozita dhe opozita, sipas përqindjes së përfaqësimit në Kuvend;

nga 1 anëtar ndërmjet 2 kandidaturave të propozuara nga:

Akademia e Shkencave,

Universiteti i Tiranës,

Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve,

si dhe 2 anëtarë ndërmjet 4 kandidaturave të propozuara nga shoqatat e gazetarëve.”.

Neni 3

Në nenin 89 fjalët “në pikën 2” zëvendësohen me fjalët “në shkronjën “b””.

Neni 4

Në nenin 90 paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Anëtarët e Këshillit Drejtues të RTSH-së nuk mund të jenë deputetë, ministra, funksionarë të lartë shtetërorë, anëtarë të organizatave politike dhe drejtues të organizatave jofitimprurëse.”.

Neni 5

Neni 93 ndryshohet si më poshtë:

“1. Anëtari i Këshillit Drejtues të RTSH-së zëvendësohet kur:

mbaron mandatin;

largohet nga detyra në përputhje me pikën 2 të këtij neni;

vdes;

ç) jep dorëheqjen;

d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

2. Kuvendi largon nga detyra anëtarin e Këshillit Drejtues të RTSH-së, me propozimin e Komisionit të Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik, kur:

a) bëhet i paafte për të kryer detyrën për shkak sëmundjeje;

b) nuk merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues për 6 muaj rresht;

c) kryen veprimtari që krijojnë konflikt interesash ose kur vërtetohen rastet e pengesave ligjore për të votuar në mbledhjet e Këshillit Drejtues, në kuptim të nenit 37 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, edhe pse ka qenë në dijeni të ekzistencës së rasteve të skualifikimit në pjesëmarrjen në vendimmarrje.

3. Kur konstatohet njëri nga rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, Kryetari i Këshillit Drejtues të RTSH-së njofton me shkrim, brenda 5 ditëve, Kuvendin dhe institucionet e tjera që kanë propozuar kandidaturën përkatëse.

4. Në rast se vendi i anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së mbetet vakant, Kuvendi, duke ruajtur raportin e përfaqësimit, zgjedh anëtarin e ri, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 88 të këtij ligji. Ky anëtar qëndron në detyrë deri në mbarimin e mandatit të anëtarit që ka zëvendësuar.”.

Neni 6

Neni 109 ndryshohet si më poshtë:

“Anëtarëve të Bordit të Administrimit nuk u lejohet që gjatë ushtrimit të funksionit të tyre të përfaqësojnë interesat e palëve të treta ose të konkurrentëve të institucionit, si dhe të jenë të lidhur me interesa biznesi me konkurrentë ose palë të treta.”.

Neni 7

Kuvendi, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ngre Këshillin e ri Drejtues të RTSH-së, sipas nenit 2 të këtij ligji.

Këshilli Drejtues ekzistues i RTSH-së vazhdon veprimtarinë e tij deri në caktimin e Këshillit të ri Drejtues, të ngritur sipas nenit 2 të këtij ligji.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3740, datë 19.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

V E N D I M **Nr.94, datë 13.2.2003**

PËR KRIJIMIN E BORDIT TË KULLIMIT PËR RRETHIN E LUSHNJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujtjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e bordit të kullimit, për rrethin e Lushnjës, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.
2. Zonat e shërbimit të kullimit të këtij bordi janë:
 - 2.1. Zona e fushës që kullon nga Emisari i Myzeqesë (LUK-1), me sipërfaqe 21300 ha.
 - 2.2. Zona e fushës që kullon nga Emisari i Tërbufit (LUK-2), me sipërfaqe 5800 ha.
 - 2.3. Zona e fushës së Divjakës dhe Karavastasë (LUK-3), me sipërfaqe 5350 ha.
 - 2.4. Zona e fushës së Karavastasë-Dega (LUK-4), me sipërfaqe 6900 ha.
 - 2.5. Zona e fushës Dega-Tërbuf (Luk-5), me sipërfaqe 8500 ha.
- Nga këto:
 - a. me rrjedhje të lirë kullojnë 32450 ha;
 - b. me ngritje mekanike kullojnë 15400 ha.
3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet:
 - a. nga 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - b. nga 3 (tre) përfaqësues të komunave brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - c. nga 2 (dy) përfaqësues të bashkive brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - ç. nga 1 (një) përfaqësues i qarkut;
 - d. nga 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - dh. nga 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.
4. Anëtarët e Këshillit të përfaqësuesve të bordit të shpërblehen çdo muaj me nga 30 për qind të pagës mujore të Drejtorit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, në qark dhe t’u paguhen shpenzimet e udhëtimit për pjesëmarrje në mbledhje, si dhe shpenzimet e udhëtimit dhe dietat, kur dërgohen me shërbim për nevojat e këtij këshilli.
5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.
6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.96, datë 13.2.2003

**PËR PËRCAKTIMIN PËR VITIN 2003 TË NUMRIT TË PUNONJËSVE TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Numri i punonjësve buxhetorë për vitin 2003 për ministritë dhe institucionet qendrore të jetë sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Për ministritë dhe institucionet qendrore, të cilat do të bëjnë shkurtime, numri i punonjësve të bëhet efektiv respektivisht nga datat 15 mars dhe 1 qershor të vitit 2003, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Shtesa e numrit të punonjësve për Ministrinë e Drejtësisë të bëhet pas fillimit të punës në burgjet e reja.
4. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

	Numri i punonjësve për vitin 2003			
		1 Janar	15 Mars	1 Qershor
1	Presidenca	60	66	66
2	Kuvendi	320	404	404
3	Këshilli i Ministrave	305	317	317
4	Ministria e Industrisë dhe Energjetikës	398	398	398
5	Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit	1350	1350	1300
6	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	405	405	405
7	Ministria e Ekonomisë	191	191	191

8	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	1360	1300	1260
9	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	242	242	242
10	Ministria e Financave	440	450	450
11	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës	44500	44400	44300
12	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1072	1070	1070
13	Ministria e Shëndetësisë	21600	21500	21400
14	Ministria e Drejtësisë	1830	2200	2200
15	Ministria e Punëve të Jashtme	157	177	177
16	Ministria e Rendit Publik	13850	13800	13800
17	Ministria e Mbrojtjes	9300	9000	9000
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	1500	1400	1400
20	Drejtoria Arkivit të Shtetit	120	120	120
21	Drejtoria e Rezervës së Shtetit	500	400	300
22	Akademia e Shkencave	600	620	620
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	150	150	150
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale	1340	1350	1350
26	Ministria e Mjedisit	80	100	100
27	Agjencia Kombëtare e Privatizimit	60	55	55
28	Prokuroria e Përgjithshme	750	720	720
29	Pushteti Gjyqësor	1140	1140	1140
30	Gjykata Kushtetuese	30	30	30
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	118	118	118
32	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	2189	2170	2170
35	Drejtoria e Doganave	1050	1050	1050
37	Drejtoria e Standardeve	25	25	25
39	Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve	1150	1100	1050
41	Drejtoria e Tatimeve	1400	1400	1400
50	Instituti i Statistikës	150	155	155
54	Enti Kombëtar i Zonave të Lira	7	7	7
55	Shkolla e Magjistraturës	15	17	17
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10	10	10
59	Instituti i Rehabilitimit të Përndjekurve Politikë	50	50	50
63	Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	15	15	15
66	Zyra e Avokatit të Popullit	45	45	45
67	Komisioni i Shërbimit Civil	25	28	28
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	45	45	45
74	Avokati i Shtetit	22	22	22
	Totali	109966	109612	109172

V E N D I M
Nr.116, datë 27.2.2003

PËR LIMITIN E PËRGJITHSHËM TË ORGANIKËS NË POLICINË E SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Limiti i përgjithshëm i organikës së Policisë së Shtetit, të jetë 12 454 veta.
2. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.117, datë 27.2.2003

PËR NJËSIMIN E FUNKSIONEVE NË POLICINË E SHTETIT ME FUNKSIONET PËRKATËSE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 15 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Njësimin e funksioneve në Policinë e Shtetit me funksionet përkatëse në administratën publike, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Përshkrimi i vendeve të punës, sipas roleve dhe gradave, të bëhet sipas aneksit nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANEKS 1
TABELA E NJËSIMIT TË FUNKSIONEVE

Kategorizimi në role i punonjësve të policisë	Klasat e nëpunësve civil sipas nenit 11 pika 1 i
---	--

sipas nenit 15 pika 2 i ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”	ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”
Roli i mesëm	Nëpunës civil të nivelit të ulët drejtues
Roli i lartë	Nëpunës civil të nivelit të mesëm drejtues
Roli madhor	Nëpunës civil të nivelit të lartë drejtues

ANEKS 2

PËRSHKRIMI I VENDEVE TË PUNËS SIPAS ROLEVE DHE GRADAVE NË POLICINË E SHETIT

a) Në gradat e rolit madhor përfshihen, gradat Drejtues i parë dhe Drejtues të barasvlefshme me funksionet Drejtor i Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm.

Disa nga detyrat funksionale për rolin madhor:

Këto funksione realizojnë drejtimin teknik dhe administrativ, bashkërendimin dhe kontrollin brenda Policisë së Shtetit, përfaqësojnë policinë në marrëdhënie me organe të tjera të administratës publike, me organizatat joqeveritare dhe me publikun brenda vendit, ndërsa në marrëdhëniet me jashtë sipas delegimit të ministrit. Nxjerr urdhërshërbime dhe letërporosi për ushtrimin e funksionit e të përgjegjësisë së tij. Kryeson (Zëvendësdrejtori) komisionin e gradimeve për rolin e lartë.

Në gradat e rolit madhor janë të barasvlefshme dhe funksionet Drejtor Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, Drejtor i Akademisë së Policisë.

Këto funksione janë niveli më i lartë i menaxhimit të Policisë së Shtetit dhe kanë përgjegjësi për hartimin e politikave në një fushë të caktuar dhe për arritjen e rezultateve të përcaktuara në këtë fushë.

b) Në gradat e rolit të lartë përfshihen, gradat Kryekomisar, Komisar, Nënkomisar të barasvlefshme me funksionet, shef sektori në DPP, shef zyre në DPP, Drejtor i Institutit të Policisë Shkencore, Drejtor i Policisë së Qarkut, Shef Komisariati i Policisë, etj.

Këto funksione bëjnë të mundur koordinimin e mendimit dhe opsioneve të reja politike për një fushë të caktuar të specialitetit, zbatimin e politikave në këtë nivel, përgatitjen e propozimeve përfundimtare, të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë. Ky nivel bën të mundur gjithashtu dhe zgjidhjen e problemeve komplekse, që lidhen me menaxhimin e projekteve të mëdha brenda institucionit.

c) Në gradat e rolit të mesëm përfshihen, gradat Kryeinspktor, Inspektor, Nëninspektor të barasvlefshme me funksionet, shefa sektori, shefa zyre, shefa seksioni, shefa nënseksioni, specialist në drejtoritë e policisë së qarqeve dhe komisariteve të policisë në repartet FS-së e FNSH-së etj..

Këto funksione merren me zbatimin e politikave ekzistuese, koordinimin e aktiviteteve të stafit mbështetës, si dhe me formulimin dhe vlerësimin e opsioneve politike mbi një fushë të caktuar duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës, njohuritë e specialitetit, analizën e informacionit dhe kërkimin.

V E N D I M

Nr.119, datë 27.2.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.119, DATË 18.3.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar dhe të nenit 7 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.119, datë 18.3.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2, pas shkronjës “ë”, shtohet shkronja “f”, me këtë përmbajtje:

“f. Aktin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të shoqërisë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, së bashku me hartën treguese.”.

2. Në shkronjën “A” të kapitullit II, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

- Pika 1 riformulohet:

“1. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit fillon menjëherë publikimin. Periudha e publikimit zgjat 30 ditë dhe bëhet në 3 gazeta me qarkullim kombëtar, 4 herë në secilën prej tyre, në njoftime në televizion, në radio dhe internet. Publikimi nëpërmjet internetit (faqja e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në internet) të njoftojë treguesit, ekonomikë dhe teknikë të shoqërisë (llogaritë vjetore). Kjo zbatohet në të gjitha rastet e publikimit për shitjen e paketave të aksioneve shtetërore.”.

- Në pikën “3”, pas fjalëve “pranë shoqërisë” shtohen fjalët “...në mjediset publike të vendndodhjes së subjektit...”.

3. Pika 1 e shkronjës “C” të kapitullit I, e shfuqizuar me vendimin nr.26, datë 24.4.2001 të Gjykatës Kushtetuese, të riformulohet si më poshtë vijon:

“1. Ish-pronarët e truallit, si subjekte kërkuese, në dallim nga subjektet e tjera kërkuese, në mbështetje të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, ndryshuar me akte të tjera ligjore, kanë të drejtë të marrin aksione të shoqërisë që privatizohet, në bazë të sipërfaqes së truallit, të përcaktuara në vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, brenda kufizimit të shoqërisë dhe çmimit të truallit, të përcaktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore, që u nënshtrohen procedurave të privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare (si dhe trojeve të shoqërive me kapital shtetëror)”.

4. Në shkronjën “A” të kapitullit II, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pika 11 riformulohet si më poshtë vijon:

“11. Vetëm kur blerësi plotëson kushtet e autorizimit, sipas pikës 8 të shkronjës “A” të kapitullit II, Agjencia Kombëtare e Privatizimit lidh me palën blerëse kontratën e shitjes së aksioneve, brenda 30 ditëve nga dita e pagesës së vlerës së plotë të paketës së aksioneve, të publikuara për shitje.”.

- Pika 12 riformulohet si më poshtë vijon:

“12. Në rast se në ankandin e shpallur nga AKP-ja nuk ka asnjë pjesëmarrës, ajo (AKP-ja) bën edhe një publikim tjetër për shitjen e paketës së aksioneve, sipas pikës 1, të shkronjës “A” kapitulli II të vendimit. Në rast se edhe pas publikimit të dytë në ankand nuk paraqitet asnjë pjesëmarrës, AKP-ja njofton Ministrinë e Ekonomisë dhe pret një urdhër të ri për mënyrën e privatizimit të paketës së aksioneve.”.

- Pas pikës 12 shtohet pikat 13 dhe 14 me këtë përmbajtje:

“13. Ministri i Ekonomisë urdhëron privatizimin nëpërmjet ankandit të shitjes së paketës shtetërore të aksioneve me vlerë më të ulët, sipas vlerësimit të bërë nga një grup ekspertësh të pavarur kontabël dhe vlerësues pasurie, të cilët do t’i japin aksionit vlerën reale të tregut, në përputhje me legjislacionin në fuqi ose në forma të tjera, të cilat mund të gjykojnë me efektive.

14. Në rastet kur në ankandet për blerjen e paketës së blerësit të vetëm nuk paraqitet asnjë kërkesë, punonjësit e shoqërisë janë zotëruar të aksioneve sipas regjistrimit të bërë, po kështu edhe ish-pronarët e truallit të shoqërisë janë zotëruar të aksioneve të shoqërisë për vlerën e truallit, si pjesë e kapitalit themeltar të shoqërisë.”.

5. Pika 1 e shkronjës “B” të kapitullit II riformulohet, si më poshtë vijon:

“1. Procedurat e shitjes së paketës të aksioneve për publikun fillojnë me publikimin, sipas

pikës 1 të kapitullit II të vendimit.”.

6. Në shkronjën “C” të kapitullit II, të bëhen këto ndryshime:

- Pika 2, riformulohet si më poshtë vijon:

“2. Me mbërritjen e urdhrin të Ministrit të Ekonomisë, i cili shoqërohet edhe me listën e aksionerëve të shoqërisë, me adresat përkatëse, AKP-ja fillon procedurat e privatizimit, sipas pikave 1 dhe 2 të kapitullit II dhe sipas pikave 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të shkronjës “A” të kapitullit II të këtij vendimi.”.

- Pika 8 riformulohet si më poshtë vijon:

“8. Kur aksionerët e shoqërisë nuk paraqiten brenda afatit ose nuk pranojnë blerjen e paketës së aksioneve nëpërmjet ankandit, AKP-ja rifillon publikimin e kësaj pakete me procedurë të zakonshme publikimi, sipas këtij vendimi.

Kur nuk realizohet shitja edhe pas ripublikimit të paketës së aksioneve, AKP-ja njofton Ministrinë e Ekonomisë dhe pret urdhrin përkatës për mënyrën e privatizimit të paketës së mbetur të aksioneve në shoqëri.

Ministri i Ekonomisë urdhëron privatizimin nëpërmjet ankandit të paketës shtetërore të aksioneve, pas vlerësimit për shitje të shoqërisë, të bërë nga një grup ekspertësh të pavarur, të cilët do t’i japin aksionit vlerën reale në përputhje me metodat bashkëkohore si: vlera e kapitalizuar aktuale e tregut; shitjet krahasuese; pasqyra e cash-it; vlera kontabël; treguesit e performancës. Vlerësimi në këtë mënyrë bëhet për të përcaktuar vlerësimin nga “tregu” të shoqërisë.”.

7. Paragrafi i fundit i pikës 9 të shkronjës “C” të kapitullit II, shfuqizohet dhe zëvendësohet me paragrafët si më poshtë vijon:

“Në shoqëritë tregtare me kapital 100 për qind shtetëror, ku trualli është futur në kapitalin e shoqërisë, sipas vendimit nr.312, datë 30.6.1994 të Këshillit të Ministrave, të bëhet rivlerësimi i truallit sipas vendimit “Për mënyrën e llogaritjes së vlerës së truallit për ndërmarrjet që do të shiten dhe ndërmarrjet që do të transformohen në shoqëri tregtare dhe procedurat e shitjes”, dhe për pasojë, diferenca e rivlerësimit (shitesë) do të reflektohet në kapital të shoqërisë.

Për shoqëritë pjesërisht të privatizuara, tek të cilat nuk janë transferuar aksionet e ish-pronarëve të truallit, këta të fundit do të hyjnë aksionerë në shoqëri për pjesën e mbetur të kapitalit shtetëror të paprivatizuar. Për shtesën e vlerës së truallit, të llogaritur në zbatim të vendimit “Për mënyrën e llogaritjes së vlerës së truallit për ndërmarrjet që do të shiten dhe ndërmarrjet që do të transformohen në shoqëri tregtare dhe procedurat e shitjes” do të zbatohen dispozitat e seksionit VI, nënseksioni I, Zmadhimi i Kapitalit Themeltar, sipas ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

Në rast se nuk realizohet procedura e mësipërme ish-pronarët do të kompensohen me njërën nga format e kompensimit, të përcaktuara me ligj.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.120, datë 27.2.2003

PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 pika 1 dhe 19 pika 1 të ligjit nr.7893,

datë 22.12.1994 “Për zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë” dhe të nenit 6 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, sipas strukturave dhe organizimit ekzistues të Shërbimit të Ekspertimit Mjekoligjor.

2. Instituti i Mjekësisë Ligjore është institucion qendror, buxhetor, në varësi të Ministrit të Drejtësisë.

3. Drejtimit e përgjithshme të veprimtarisë të këtij Instituti janë:

a) Veprimtaria kërkimore-shkencore për zbulimin dhe zbatimin e metodave bashkëkohore në fushën e mjekësisë ligjore.

b) Organizimi dhe drejtimi i veprimtarisë së shërbimeve të ekspertimit mjekoligjor në Republikën e Shqipërisë.

c) Kryerja e ekspertimeve mjekoligjore, patologjike, toksikologjike, biologjike dhe psikiatrike, si dhe e veprimeve të tjera, sipas rasteve dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurës Penale dhe në ligje të veçanta.

ç) Bashkërendimi i veprimtarisë së këtij Instituti me institucionet shëndetësore për parandalimin e veprave penale, që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e pacientëve.

d) Përgatitja dhe kualifikimi i vazhdueshëm shkencor i specialistëve të mjekësisë ligjore.

4. Instituti i Mjekësisë Ligjore, sipas ligjit, kryen ekspertime mjekoligjore, me kërkesën e palëve në procesin civil, të subjekteve të procedimit penal dhe të personave të tjerë juridikë, kundrejt pagesës së shpenzimeve dhe të tarifave përkatëse.

5. Tarifat për veprimet dhe shërbimet, që ofron Instituti i Mjekësisë Ligjore, masa dhe mënyra e llogaritjes së këtyre shpenzimeve, caktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Financave.

6. Vendimi nr.343, datë 5.6.1998 i Këshillit të Ministrave “Për kalimin në varësi të Ministrisë së Drejtësisë të Shërbimit të Ekspertimit Mjekoligjor”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.123, datë 27.2.2003

PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM , PËR PËRGJEGJËSITË NDAJ PALËVE TË TRETA, TË MJETEVE MOTORIKE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar me ligjin nr.8767, datë 5.4.2001, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Institucionet buxhetore, për fondet limit, të miratuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2003, të përdorin procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me INSIG sh.a. për sigurimin e detyrueshëm, për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, të mjeteve të tyre motorike.

2. Primi, që INSIG sh.a. do të arkëtojë nga institucionet buxhetore, të jetë vlera e primit të pastër, shtuar vlerën e shpenzimeve minimale administrative, të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Financave.

3. Ngarkohen institucionet buxhetore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.125, datë 27.2.2003

**PËR TRAJTIMIN ME SHITESË, PËR VËSHTIRËSI VENDI E SHËRBIMI, TË
USHTARAKËVE, QË SHËRBEJNË NË STRUKTURAT E BRIGADËS SË REAGIMIT TË
SHPEJTË DHE TË BRIGADËS SË STËRVITJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të nenve 24 pika 1 dhe 29 pika 2 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ushtarakët aktivë të brigadës së reagimit të shpejtë dhe të brigadës së stërvitjes të trajtohen me shtesë mbi pagën bazë mujore, për vështirësi vendi e shërbimi, deri 80 për qind të kësaj page.

2. Shkallëzimi i kësaj shtese të bëhet nga Ministri i Mbrojtjes, në përputhje me funksionet organike.

3. Ushtarakët, që do të trajtohen me këtë vendim, nuk përfitojnë shtesën mbi pagën bazë, për vështirësi vendi e shërbimi, sipas vendimit nr.60, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesë mbi pagë të ushtarakëve dhe punonjësve civilë në ushtri”.

4. Efektet financiare për këtë vit, në vlerën 50 (pesëdhjetë) milionë lekë të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, ndaj ky fond nga zëri “Mallra e shërbime” të kalojë në zërin “Shpenzime për pagat”.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet financiare nga data 1.6.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.126, datë 27.2.2003

**PËR KRITERET E DHËNIES SË LEJES TË PËRPUNIMIT INDUSTRIAL DHE/OSE TË
PRODHIMIT TË PRODUKTEVE TË DUHANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr.8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të

V E N D O S I:

1. Për dhënien e lejes së përpunimit industrial dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit, të bëhet kërkesë me shkrim pranë Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve (AKDC), e cila të shoqërohet me:

- a) Vendimin e gjykatës për regjistrimin e personit fizik ose juridik.
- b) Vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve nga organet tatimore, vetëm për subjektet që e ushtrojnë aktualisht këtë veprimtari dhe për subjektet që kryejnë veprimtari tjetër biznesi.
- c) Të dhënat për kushtet teknike dhe teknologjinë e instaluar, ku të përfshihen:

I. Projekti teknologjik i përpunimit industrial dhe/ose i prodhimit të produkteve të duhanit me elementet si më poshtë vijon:

- përshkrimi i mjedisit (mjediset kryesore dhe ndihmëse);
- pajisjet e instaluara, proceset teknologjike (përshkrimi i shkurtër i teknologjisë së prodhimit) dhe kapacitetet e prodhimit;
- lëndët e para dhe ndihmëse dhe karakteristikat kryesore të tyre;
- produktet e gatshme dhe karakteristikat kryesore të tyre (kryesisht për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve).

II. Standardi me të gjithë treguesit cilësorë të sigurisë.

III. Ambalazhimi, etiketimi, ruajtja dhe transportimi i produkteve të gatshme.

IV. Afatet e garancisë ose jetëgjatësisë së produktit/data e prodhimit.

V. Krjimi dhe largimi i mbetjeve teknologjike të mundshme.

VI. Të dhëna të tjera për rastet e prodhimeve të veçanta.

2. Leja e përpunimit industrial dhe/ose e prodhimit të produkteve të duhanit merret pasi të jetë kryer vlerësimi i të dhënave për kushtet teknike dhe teknologjinë e instaluar dhe pasi të shlyhet tarifa përkatëse, që përcaktohet nga Ministri i Financave e Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit dhe administrohet nga AKDC-ja, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Vlerësimi i të dhënave për kushtet teknike dhe teknologjinë e instaluar të bëhet nga Komisioni i Ekspertëve pranë AKDC-së, i cili ngrihet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Nëse personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, që kryejnë përpunimin industrial të duhanit dhe prodhimin e produkteve të tij, nuk paraqesin lejen e përpunimit industrial dhe/ose lejen e prodhimit të produkteve të duhanit, organet tatimore nuk i regjistrojnë ata.

4. Afati i pajisjes me lejen e përpunimit industrial dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit është 30 ditë nga çasti i dorëzimit të kërkesës pranë AKDC-së. Pajisja me leje bëhet sipas formatit tip, të miratuar nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit. Leja e përpunimit industrial dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit është e vlefshme për 10 (dhjetë) vjet, me të drejtë përtëritje.

5. Leja e përpunimit industrial dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit, e miratuar, regjistrohet në regjistrime përpunuesve të duhanit dhe të prodhimit të produkteve të tij, pranë AKDC-së.

6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe AKDC-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M
Nr.127, datë 13.2.2003

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.530, DATË 31.10.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR QUKËS-QAFË**

THANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.530, datë 31.10.2002 të Këshillit të Ministrave, në listën e fundit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, pas numrit rendor 12, shtohet numri rendor 13, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Pronar	Nr.pasurisë	Sip.e objektit m2	Çmimi në lek/m2	Totali (lekë)
13	Gëzim Curra	Km 16+ 360	247	Preventiv	1 574 500
	Shuma		1330.6		17 308 240

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M Nr.133, datë 7.3.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SHQIPTARE DHE QEVERISË MAQEDONASE, PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E SHËNDETËSISË DHE TË SHKENCAVE MJEKËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase, për bashkëpunim në fushën e shëndetësisë dhe të shkencave mjekësore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SHQIPTARE DHE QEVERISË MAQEDONASE PËR BASHKËPUNIM
NË FUSHËN E SHËNDETËSISË DHE SHKENCAVE MJEKËSORE

Qeveria Shqiptare dhe Qeveria Maqedonase (në tekstin e mëtejshëm) “palë kontraktuese”) duke patur parasysh frymën ekzistuese të miqësisë dhe ndihmën e ndërsjellë në marrëdhëniet bilaterale dhe të udhëhequra nga dëshira e vendosjes së bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë dhe shkencave mjekësore, që është në interes të qytetarëve të të dy vendeve, ranë dakord për sa vijon:

Neni 1

Palët Kontraktuese në sferën e shëndetësisë dhe shkencave mjekësore e zhvillojnë dhe nxisin bashkëpunimin në bazë të barazisë, reciprocitetit dhe interesit të përbashkët.

Neni 2

Palët Kontraktuese bashkëpunojnë në këto sfera prioritare:

- reformat në sistemin e mbrojtjes shëndetësore dhe në sistemin e sigurimit shëndetësor;
- legjislaturën shëndetësore;
- shkencat mjekësore;
- menaxhimin në entet shëndetësore;
- promovimin e shëndetit dhe preventivën për sëmundjet kronike joinfektuese;
- kontrollin sanitar të ushqimit, mallrave dhe faktorëve të ambientit jetësor, që ndikojnë mbi shëndetin e popullatës;
- kontrollin epidemiologjik të sëmundjeve infektuese dhe parazite;
- veprimtarinë farmaceutike;
- shkencat mjekësore.

Bashkëpunimi në sferat e përmendura nuk përjashton edhe sfera të tjera me interes të përbashkët.

Neni 3

Palët Kontraktuese përdorin këto mënyra të bashkëpunimit:

- këmbimi i informatave në sferën e shëndetësisë;
- këmbimi i kuadrit mjekësor;
- kontakte të drejtpërdrejta midis fakulteteve mjekësore, qendrave kombëtare, projekte të përbashkëta në lidhje me problemet dhe temat me interes të ndërsjellë dhe këmbimi i lektorëve;
- forma të tjera të harmonizuara reciprokisht të bashkëpunimit në sferën e shëndetësisë dhe shkencave mjekësore.

Neni 4

Palët Kontraktuese informohen për ngjarjet mjekësore me pjesëmarrje ndërkombëtare në vendet e veta. Për këtë qëllim dërgohen informacione vjetore për kongreset dhe simpoziumet mjekësore me pjesëmarrje ndërkombëtare, që do të mbahen në secilin nga vendet.

Neni 5

Për studimin e problemeve të caktuara Palët Kontraktuese bëjnë këmbimin e mjekëve, stomatologëve, farmacistëve, lektorëve, profesorëve universitar, si dhe të kuadrit tjetër mjekësor. Numri i kuadrit mjekësor përcaktohet në planet për bashkëpunim.

Neni 6

Palët Kontraktuese i përcaktojnë Ministrinë Shqiptare të Shëndetësisë dhe Ministrinë

Maqedonase të Shëndetësisë, si organe kompetente, për koordinimin e aktiviteteve në lidhje me realizimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Për realizimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese kanë rënë dakord që Ministritë e Shëndetësisë të të dy vendeve të firmosin plane për bashkëpunim në kohëzgjatje prej tre vjetësh, me të cilat i përcaktojnë aktivitetet në sferat e bashkëpunimit dhe kushte financiare për realizimin e aktiviteteve përkatëse.

Neni 8

Palët Kontraktuese e koordinojnë aktivitetin e vet në kuadrin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe organizatave të tjera ndërkombëtare që bashkëpunojnë në sferën e shëndetësisë.

Neni 9

Palët Kontraktuese ranë dakord të sigurohet mjekimi i 20 pacientëve nga Republika Shqiptare, si raste urgjente për hemodializë në kohëzgjatje në një cikël për një vit, në entin e nefrologjisë – Strugë dhe shpenzimet i kryen Qeveria Maqedonase.

Neni 10

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së notës së fundit diplomatike, me të cilën nëpërmjet rrugës diplomatike Palët Kontraktuese reciprokisht informohen se i kanë plotësuar kushtet në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm për hyrje në fuqi të Marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje nënshkruhet për një periudhë 5-vjeçare dhe vazhdon të vlejë një periudhë ose periudha të ngjashme, vetëm nëse gjashtë muaj para skadimit të periudhës fillestare ose të periudhave pasuese secila nga Palët Kontraktuese e informon Palën tjetër Kontraktuese për qëllimin e saj për prishjen e Marrëveshjes.

Bërë në Shkup, më 23.2.2001, në dy kopje identike në gjuhën shqipe dhe maqedonase, të dy kopjet kanë vlerë të njëjtë.

V E N D I M **Nr.134, datë 7.3.2003**

PËR VËRTETIMIN DHE LEGALIZIMIN E DOKUMENTEVE TË LËSHUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, PËR PËRDORIM JASHTË VENDIT DHE TË DOKUMENTEVE TË HUAJA, PËR PËRDORIM BRENDË VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 23 të ligjit nr.8372, datë 9.7.1998 “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore” dhe të shkronjës “d” të nenit 6 të ligjit n.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Vërtetimi i dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit, të bëhet:

- a. institucionet e administratës publike, të nivelit qendror, që më poshtë do të quhen “institucione qendrore”, si për dokumentet e lëshuara nga vetë ato dhe nga institucionet e varësisë ose institucionet e linjës;
- b. institucionet e pavarura, për dokumentet e lëshuara nga administrata e tyre;
- c. nga prefektët, për dokumentet e lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore.

“Institucionet qendrore” dhe “institucione të pavarura”, në kuptim të këtij vendimi, janë institucionet e parashikuara në nenin 2 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

2. Dokumentet e vërtetuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, të lëshuara nga institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe prefektët, legalizohen nga nëpunësit konsullorë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.

3. Aktet e lëshuara nga noteri legalizohen drejtpërdrejtë nga nëpunësit konsullorë.

4. Dokumentet e autoriteteve të huaja, që do të përdoren brenda vendit, legalizohen në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, ndërsa dokumentet e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara në Tiranë, legalizohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

5. Në vendet ku Republika e Shqipërisë nuk ka përfaqësi të akredituar, legalizimi i dokumenteve të huaja, të legalizuara më parë nga Ministria e Jashtme e vendit të origjinës, kryhet në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

6. Modeli i vërtetimit dhe legalizimit të dokumentit është sipas lidhjeve nr.1 dhe nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Ndryshimet e modeleve bëhen nga Ministri i Punëve të Jashtme, i cili njofton menjëherë institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe prefektët.

7. Titullarët e institucioneve qendrore, të institucioneve të pavarura dhe prefektët, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dërgojnë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme emrat e personave të ngarkuar, për vërtetimin dhe lëshimin e dokumenteve, si dhe depozitojnë specimenet e nënshkrimeve të tyre dhe gjurmët e vulave zyrtare.

8. Në rast largimi të personave të përcaktuar sipas pikës së mësipërme, titullarët e institucioneve qendrore, të institucioneve të pavarura dhe prefektët njoftojnë menjëherë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe depozitojnë pranë saj nënshkrimet e personave zëvendësues.

9. Ministria e Drejtësisë njofton menjëherë Ministrinë e Punëve të Jashtme për emërimin ose largimin nga detyra të noterit dhe depoziton nënshkrimin dhe gjurmët e vulave të tij.

10. Ngarkohen institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe prefektët për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja 1
Modeli i vërtetimit

(Institucioni i administratës publike/prefekti)

Nr. _____
Vërtetohet autenticiteti i nënshkrimit të znj./z
(Emri,mbiemri i nëpunësit lëshues)
me funksion
(funksioni zyrtar)
dhe vula zyrtare
(Emri,mbiemri i nëpunësit vërtetues)
(Nënshkrimi)
(Vendi), më (Data)
(Vula zyrtare e institucionit qendror)

Lidhja 2
Modeli i legalizimit

(Ministria e Punëve të Jashtme/Përfaqësia)
No. _____

Hereby is certified the authenticity of signing
of Mrs/Mr./

Vërtetohet autenticiteti i nënshkrimit të znj./z

(Emri,mbiemri i nëpunësit vërtetues)

in the capacity / me funksion

(funskioni zyrtar)

and the official seal / dhe vula zyrtare

(Emri,mbiemri i nëpunësit konsullor)

(Nënshkrimi)

(Vendi), (Data)

(Vula zyrtare)

V E N D I M
Nr.136, datë 7.3.2003

PËR SHPËRNDARJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 56 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin e arsimit parauniversitar”, ndryshuar me ligjin nr.8387, datë 30.7.1998 dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Marrjen në përdorim falas në bibliotekën e shkollës, duke filluar nga viti shkollor 2003-2004, të teksteve shkollore nga të gjithë nxënësit e arsimit të detyruar, me detyrimin që t’i dorëzojnë në fund të vitit mësimor.

2. Këto tekste, që janë pronë e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, të përdoren për një periudhë deri në tre vjet.

3. Kostoja e plotë e botimit, shtypjes dhe shpërndarjes së teksteve, për vitin 2003, të mbulohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, nga subvencioni i parashikuar për këto tekste dhe nga fondet e dhëna nga Banka Botërore, për projektin “Reforma në arsim I”, kredia nr.3343-ALB.

4. Zhdëmtimi për tekstet e humbura dhe të papërdorshme të bëhet nga përdoruesi në masën e kostos së plotë, duke zbritur 25 për qind të vlerës fillestare për çdo vit përdorimi.

5. Fletoret e punës për nxënësit e arsimit të detyruar, që nuk përdoren më shumë se një vit shkollor dhe tekstet shkollore të arsimit të mesëm, të subvencionohen nga shteti dhe të blihen nga nxënësit, me çmimin e përcaktuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrisë së Financave.

6. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, me fondet e saj buxhetore vjetore, të hartojë dhe zbatojë skemën e re për subvencionimin e teksteve shkollore.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**SKEMA E BOTIMIT DHE SHTYPJES SË TEKSTEVE SHKOLLORE PËR NXËNËSIT E
ARSIMIT TË DETYRUAR NË VITET 2003-2015**

Skemë me ripërdorim cikli 3-vjeçar

Plan në vite	Viti shkollor	Klasa I	KlasaII	Klasa III	Klasa IV	Klasa V	Klasa VI	Klasa VII	Klasa VIII
1	2003- 2004	B.Mash	B.MASH	B.MASH SH.BB	B.MASH Sh.BB.	B.MASH SH.BB	B.MASH	B.MASH SH.BB	B.MASH SH.BB
2	2004- 2005	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Ripërdorim	Ripërdorim
3	2005- 2006	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Ripërdorim
4	2006- 2007	Ripërdorim	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Rishtypje MASH	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja
5	2007- 2008	Rishtypje	Ripërdorim	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim
6	2009- 2010	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim
7	2011- 2012	Ripërdorim	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Rishtypje MASH
8	2012- 2013	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorimi	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim
9	2013- 2014	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim
10	2014-	Ripërdorim	Ripërdorim	Rishtypje	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Rishtypje

	2015			MASH					MASH
--	------	--	--	------	--	--	--	--	------

V E N D I M
Nr.138, datë 7.3.2003

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në paragrafin e parë të pikës 8.3, pas emërimit “Hani i Hotit”, shtohen emërtimet: “Muriqan, Bashkim Vermosh”.
2. Paragrafi i pestë i pikës 8.3 riformulohet si më poshtë vijon:
“Drejtoria rajonale nr.5 e ka selinë në Gjirokastrë dhe ka në varësi degët doganore: Gjirokastrë (Kakavijë), Sarandë (Qafë Botë, Rips), Tri Urat”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.141, datë 7.3.2003

**PËR PËRCAKTIMIN E PAGESËS VJETORE PËR MBAJTJEN E SË DREJTËS TË
SELEKSIONERIT TË BIMËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.8880, datë 15.4.2002 “Për të drejtat e seleksionerit të bimëve”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Masa e pagesës vjetore për mbajtjen e së drejtës të seleksionerit të bimëve në regjistrin përkatës të jetë 4000 (katër mijë) lekë dhe për ndryshimin e përshkrimeve në regjistrin të jetë 1 000 (një mijë) lekë.
2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.146, datë 7.3.2003

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.675, DATË 20.12.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE, TË PLANIFIKUARA PËR
MALLRAT, SHËRBIMET DHE NDËRTIMET”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.675, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 6.1 shtohet pika 6.1/1, me këtë përmbajtje:

“6.1/1. Pika 6.1 nuk zbatohet për prokurimin e mallrave që prishen, si fruta-zarzavate të freskëta ose artikuj të tjerë të ngjashëm, të përfshirë në listën që do të hartojë Agjencia e Prokurimit Publik.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Vendim i KM nr.138, datë 7.3.2003	 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave“Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”.....	530
Vendim i KM nr.141, datë 7.3.2003	Për përcaktimin e pagesës vjetore për mbajtjen e së drejtës së seleksionerit të bimëve.....	531
Vendim i KM nr.146, datë 7.3.2003	Për një ndryshim në vendimin nr.675, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve buxhetore, të planifikuara për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet”.....	531

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 21.3.2003
Doli nga shtypi më 21.3.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë